




REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dop. Dop.	DPK
Nr. Prot. B. Prot. Prot. No.	03-02/4086/17
Data Datum Dat.	13.12.2017
Nr. Treg. Zëq. shprehje Nr. pages.	02



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 11.12.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2444/17, për znj. Gylimsere Kundja, Zëvendës Konsulle në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Itali, për shkak se zyrtarja e lartë publike e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtaren e lartë, znj. Gylimsere Kundja, Zëvendës Konsulle në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Itali dhe njëkohësisht “person i autorizuar” në biznesin privat Nova Service S.R.L “Përfaqësia në Kosovë”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtarja e lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese zyrtarja e lartë është njoftuar me fakte se ushtrimi i funksionit menaxhues në biznes privat është i ndaluar neni (15 paragrafi 1) të Ligjit nr.04/L-051, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Zyrtarja e lartë, është deklaruar se biznesi është pasiv dhe nuk zhvillon aktivitet, prandaj ajo ka pranuar kërkesën e Agjencisë për të bërë ndryshimet e kërkuara në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar një shkresë zyrtare të lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/3755/17) me të cilën dëshmohet se zyrtarja e lartë është larguar nga funksioni “person i autorizuar” në biznesin privat të cekur më lartë. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

